

DOKUMENTACIONI PËR LEJE NDËRTIMI / RIKONSTRUKSIONI
për shqyrtim paraprak në **Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit**
Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Territorit

FAZA 1: DOSJA E APLIKIMIT PËR LEJE NDËRTIMI DUHET TË PËRMBAJË:

1. Kërkesë zyrtare e ministrit të linjës drejtuar Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) për shqyrtim të lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT);
2. Opinioni tekniko-ligjor i ministrisë së linjës;

DOKUMENTACIONI LIGJOR

3. **Çertifikatë regjistrimi nga QKR** e kompanisë aplikuese;
4. **Licencat e projektuesve;**

TOKA/ TRUALLI

5. **Çertifikatë pronësie**, bashkëngjitur të cilës dhe kopja e kartelës shoqëruese nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (e marrë në tre muajt e fundit);

TRASHËGIMIA KULTURORE

6. **Vërtetim i Institutit të Monumenteve të Kulturës për prezencë ose jo të monumenteve në territorin ku aplikohet** (në rastet kur objekti klasifikohet si monument kulture ose ndodhet pranë një të tillë)
7. Vendim Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (**KKR**), sipas dispozitave të legjislacionit të posaçëm sektorial, (në rastet kur objekti klasifikohet si monument kulture).

MJEDISI

8. **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis** (nga subjekt i licencuar);
9. **Miratim për VNM paraprake/Leje / deklaratë ose pëlqim mjedisor** (sipas dispozitave ligjore në fuqi/për rastet kur ndryshon gjurma e objektit ekzistues)

DOKUMENTACIONI TENIK

10. **Harta ku paraqitet plani i vendosjes së strukturës dhe parametrat urban, në format A1 ose A0;**
11. **Projekti/ materiali grafik përkatës** në formatin A3 (20-30 fletë), ku ndër të tjera duhet të përmbajë:
 - 11.1 **Hartën e Infrastrukturës inxhinierike**, ku të tregohet gjendja ekzistuese e infrastrukturës në zonë dhe lidhja e strukturës që propozohet me të;
 - 11.2 Si pjesë e materialit grafik duhet të jenë edhe **imazhet 3D të objektit/eve** ku të lexohet arkitektura dhe impakti me kontekstin përreth (fotomontazh);
 - 11.3 **Koordinatat gjeografike** të projekt – propozimit në projeksionin UTM 34 N.
 - 11.4 projekti duhet të jetë në përputhje me:
 - **standardet për aksesueshmërinë nga persona me aftësi të kufizuar,**
 - **dispozitat e mbrojtjes kundër zjarrit.**
12. **Relacion teknik i projekt – propozimit në format A4 (10-20 fletë);**
13. **Grafiku i punimeve dhe organizimi i procesit të punës/plani i organizimit të punimeve;**
14. **Preventiv i realizimit të punimeve;**
15. **Raporti gjeologo-inxhinierik – sizmik – hidrologjik;**
16. **Oponencë teknike nga Instituti i Ndërtimit për projektin, nëse vlera tejkalon 100.000.000 (njëqind milionë lekë);**
17. **Shkresa për aplikim të shoqërohet me CD të dokumentacionit ligjor dhe teknik të listuar më sipër, të skanuar nga origjinali.**

TË RËNDËSISHME:

- Dokumentacioni ligjor dhe Vërtetimet e Institucioneve do të dorëzohen në një **kopje origjinale ose fotokopje të noterizuar** pranë Ministrisë së linjës nga pala e interesuar;
- Dokumentacioni Teknik/ Materiali grafik do të dorëzohet në një **kopje origjinale të firmosur nga projektuesit**, pranë Ministrisë së linjës nga pala e interesuar.

BOTIMI NË REGJISTRIN E INTEGRUAR TË TERRITORIT:

- Në bazë të nenit 56, të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, materiali i mësipërm duhet të botohet në Regjistrin e Integruar të Territorit nga Ministria e linjës, si autoritet kombëtar i planifikimit të territorit, i cili **ka detyrim ligjor botimin e të gjitha projektakteve dhe akteve nga momenti i depozitimit të kërkesës e deri në miratimin përfundimtar të saj.**

FAZA 2: PËR PREZANTIM NË KKT: SUBJEKTI APLIKUES DUHET TË PËRGATISË SIPAS UDHËZIMEVE TË AKPT:

1. **Relacion teknik** i përmbledhur për prezantim në KKT, në format A4 (3-6 fletë);
2. **Harta ilustruese të projekt – propozimit** dhe pamje 3 dimensionale në format A3 (1-3 fletë);
3. **Harta e Planvendosjes së Strukturës së projekt-propozimit** në formatin final të miratimit (sipas formatit të përcaktuar nga AKPT);
4. **Prezantimi në PPT** të projekt – propozimit .
5. Materiali i përgatitur për prezantim në KKT do të dorëzohet pranë AKPT-së nga subjekti aplikues, vetëm pasi AKPT të njoftojë aplikuesin zyrtarisht për përputhshmërinë e projekt-propozimit me instrumentat e planifikimit në fuqi dhe Ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, dhe përcaktimit të datës së mbledhjes së KKT-së.

FAZA 3: PAS MIRATIMIT NË KKT: SUBJEKTI APLIKUES DUHET TË PËRGATISË SIPAS UDHËZIMEVE TË AKPT:

1. **Harta e Planvendosjes së Strukturës së projekt-propozimit** në formatin final të miratimit (sipas formatit të përcaktuar nga AKPT), në 6 kopje.

✓ ***Plotësimi i pikave të mësipërme (1-17) është kusht i domosdoshëm që aplikimi të përcillet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit.***